

**Përrjashtim i Kufizuar nga Dhënia e
Informacioneve Shpjeguese Krahasuese
sipas SNRF 7 për zbatuesit për herë të parë
(Amendim i SNRF 1)**

Amendim i SNRF 1 Zbatimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

Shtohet Paragrafi 39C.

Data efektive

39C *Përjashtim i Kufizuar nga Dhënia e Informacioneve Shpjeguese Krahasuese sipas SNRF 7 për zbatuesit për herë të parë*, (Amendim i SNRF 1) publikuar në Janar 2010, shtoi paragrafin E3. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë amendim për periudhat ushtrimore që fillojnë në ose pas datës 1 Korrik 2010. Lejohet zbatimi më i hershëm i këtij amendimi. Nëse një njësi ekonomike zbaton këtë amendim për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacion shpjegues për këtë fakt

Shtojca E Përjashtime afat-shkurtra nga SNRF-të

Është shtuar një titull, paragrafi E3 dhe një shënim në fund të faqes.

Dhënie informacionesh shpjeguese për instrumentat financiarë

E3 Një zbatues për herë të parë mund të zbatojë dispozitën kalimtare në paragrafin 44G të SNRF 7.*

* Paragrafi E3 u shtua si rrjedhojë e *Përjashtimit të Kufizuar nga Dhënia e Informacioneve Shpjeguese Krahasuese sipas SNRF 7 për Zbatuesit për Herë të Parë* (Amendim i SNRF 1) publikuar në Janar 2010. Për të shmangur përdorimin e mundshëm të perceptimeve dhe për të siguruar se zbatuesit për herë të parë nuk janë të disavantazuar në krahasim me përgatitësit aktualë të SNRF-ve, Bordi vendosi që zbatuesit për herë të parë të lejohen të përdorin të njëjtën dispozitë kalimtare që lejohet për përgatitësit ekzistues të pasqyrave financiare të përgatitura në përputhje me SNRF-të që janë përfshirë në *Përmirësimi i Dhënies së Informacioneve Shpjeguese për Instrumentat Financiarë* (Amendime të IFRS 7)

Shtojcë

Amendim i SNRF 7 *Instrumentat Financiarë:* *Dhënia e Informacioneve Shpjeguese*

Paragrafi 44G është amenduar (teksti i ri pas amendimit është nënvizuar dhe teksti i hequr është mesvizuar) shoqëruar me shënim në fund të faqes.

Data efektive dhe kalimi

44G *Përmirësimi i Dhënies së Informacioneve Shpjeguese për Instrumentat Financiarë* (Amendime të SNRF 7), publikuar në Mars 2009, amenduan paragrafët 27, 39 dhe B11 dhe shtuan paragrafët 27A, 27B, B10A dhe B11A-B11F. Një njësi ekonomike duhet ti zbatojë këto amendime për periudhat ushtrimore që fillojnë në ose pas datës 1 Janar 2009. ~~Në vitin e parë të zbatimit, një njësi ekonomike nuk ka nevojë të japë informacion krahasues për informacionet shpjeguese të kërkuara nga amendimet për:~~

(a) një periudhë vjetore ose të ndërmjetme, duke përfshirë ndonjë pasqyrë të pozicionit financiar, paraqitur brenda një periudhe vjetore krahasuese që mbaron para datës 31 Dhjetor 2009, ose

(b) ndonjë pasqyrë të pozicionit financiar në fillim të periudhës më të hershme krahasuese në një datë para datës 31 Dhjetor 2009.

Lejohet zbatimi më i hershëm i këtyre amendimeve. Nëse një njësi ekonomike zbaton këto amendime për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacion shpjegues për këtë fakt.*

* Paragrafi 44G u amendua si rrjedhojë e *Përrjashtimit Kufizues nga Dhënia e Informacioneve Shpjeguese sipas SNRF 7 për Zbatuesit për Herë të Parë* (Amendimi i SNRF 1) publikuar në Janar 2010. Bordi amendoi paragrafin 44G për të qartësuar konkluzionet e tij dhe kalimin e synuar drejt *Përmirësimit të Dhënies së Informacioneve Shpjeguese për Instrumentat Financiarë* (Amendimet e SNRF 7).